

**AKT THEMELIMI DHE STATUT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
Everest Automotive shpk**

Ne Tirane, sot ne date 12/04/2021;

Bazuar ne vendimin e asamblese se shoqerise “Everest” sh.p.k me date 21.01.2021 dhe me seli ne adresen: Bashkia Kamez, Fabrika ne rrugen nacionale, prane nyjes se betonit, Kamez, Tirane, kjo e fundit e perfaqsuar me vendimin e asamblese se ortakeve, nga z.Albert Valteri, i biri i Hajredin-it, i dtl.16.08.1981, lindur ne Vinjoll, Mat, banues në njesine administrative Kashar, Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i leternjofimit me nr.personal I10816168D .

Me cilesin e ortakut te vetem kam redaktuar këtë akt themelimi dhe statut, per krijimin e shoqërise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin Everest Automotive shpk, në respektim te Kodit Civil, Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit”, i ndryshuar, neni 28, pika-5 e ligjit nr.8438 date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar dhe VKM nr.141 date 13.02.2020 “Per percaktimin e aktiviteteve te kritereve dhe procedurave per personat j juridike qe ushtroojne veprimatri ekonomike ne industrine automotive”, etje.

**Neni 1  
Emertimi i Shoqerise**

- 1.1 Shoqeria e emertuar Automotive Industry Everest Albania shpk (me poshte e quajtur “Shoqeria”), eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.
- 1.2 Emertimi i shkurtuar i shoqerise do te jete Everest Automotive shpk, i cili do te perdret ne cdo dokument, logo dhe publikim nga shoqeria dhe njohje nga te trete.
- 1.3 Shoqeria eshte themeluar sipas Ligjit 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

**Neni 2  
Selia**

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Bulevardi Blu, nr.544, prane shoqerise “Everest shpk, Kamez, Tirane, Shqiperi.
- 2.2 Shoqeria mund te hape zyra perfaqesimi, dege dhe/ose filiale dhe/ose te marre pjese ne shoqeri te tjera, te kryeje aktivitet ne vende te tjera, qofte brenda apo jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

**Neni 3  
Kohezgjatja**





Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

#### **Neni 4 Objekti**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te perfshije, por nuk do te kufizohet vetem ne fushen e; *Projektim, zhvillim, prodhim, tregtim dhe shitje te automjeteve dhe pjeseve perberese apo te vecanta per mjetet motorrike dhe te tjere mjete te levizshem te industrise Automotive.*

Ne pergjithesi, Shoqeria mund te kryeje çdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji per realizimin e objektit te aktivitetit te saj.

#### **Neni 5 Kapitali**

- 5.1 Kapitali i Shoqerise eshte ne vleren 1,000,000 (nje milion) EUR, i ndare ne 1(nje) kuote, vlera e te cilave zoterohet nga Ortaku i vetem i shoqerise, si me poshte:
- Shoqeria Everest shpk eshte zoteruese e 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 100% te kapitalit per vleren 1,000,000.00(nje million) EUR ose kundervlera ne ALL, leke;
- 5.2 Kuota eshte e transferueshme dhe mund te transferohen ne çdo kohe ne perputhje me kushtet dhe afatet qe percaktohen ne ligjin shqiptar. Pergjegjesia e Ortakut shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

#### **Neni 6 Asambleja e Pergjithshme e Ortakut te Vetem**

- 6.1 Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te ketij Statuti, asambleja e pergjithshme e ortakut te vetem te Shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i Shoqerise. Ajo perfaqeson te gjithe ortaket dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, jane detyruese per te gjithe ortaket, perfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim dhe qe votojne kunder ketyre vendimeve.
- Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve te meposhteme:
- a) percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise;
  - b) miratimi i ndryshimeve te statutit;
  - c) emerimi e shkarkimi i anetareve te Keshillit Administrativ/Administratorit te Vetem si dhe percaktimi i kompetencave dhe shperblimit te tyre;
  - d) emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe Audituesve Ligjor si dhe percaktimi i shperblimit te tyre;
  - e) mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Keshilli Administrativ/Administratori i Vetem, perfshire mbikeqyrjen e pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
  - g) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
  - h) pjesetimin e kuotave, shuarjen apo edhe anulimin e tyre, ndarjen e dividenteve ne perpjestim me kuoten takuese ose ne cdo menyre tjeter por ne marveshje dhe miratim nga te gjithe ortaket ;
  - i) caktimin e perfaqesuesit te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj anetareve te Keshillit Administrativ/Administratorit te Vetem;



- j) miratimin e riorganizimit të Shoqërisë, përfshirë bashkimin me shoqëri të tjera, ndarjen e Shoqërisë, shndërrimin e Shoqërisë si dhe prishjen e Shoqërisë;
  - k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese se ortakeve.
  - l) ceshtje të tjera të parashikuara nga Ligji apo statuti.
- Ortaku apo çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblese duke patur të drejtën e votes në raport me vlerën nominale të kuotes së tij. Çdo ortak mund të përfaqësohet në vendimarrje nga një ortak tjetër, nga bashkeshorti(ja) ose nga çdo person tjetër, me kushtin që përfaqësuesit të jenë të pajisur me autorizimin për atë qëllim. Administratoret e shoqërisë nuk mund të jenë përfaqësues të ortakeve në mbledhjet e Asamblese se Ortakeve. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblese se ortakeve, por përfshin edhe mbledhjet me të njëjtin rend dite.
- 6.2 Administratori(et) sipas gjykimit të tij të lirë ose me kërkesën e një dhe/ose me shumë ortakeve të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë dhe/ose Audituesit Ligjor nëse ka, dhe/ose likuiduesit kanë të drejtë të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme të Ortakeve. Në këtë rast ortakeve duhet t'iu dërgohet një njoftim me shkrim për mbledhjen me postë elektronike (email) jo më vonë se 7 ditë përpara datës së mbledhjes, i cili thekson qëllimin, vendin dhe orën e mbledhjes.
- Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve thirret të paktën një herë në vit brenda 6 muajve nga përfundimi i vitit ushtrimor.
- 6.3 Përveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve vendos në mënyrë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë me shumë se 30% (tridhjetë përqind) të numrit total të votave dhe vendimet merren me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- Për të vendosur shpërndarjen e fitimit, ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar si dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm ose të përfaqësuar ortakët që zoterojnë me shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të numrit total të votave. Vendimi merret me votën pro të të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë) përqind të ortakeve të pranishëm.
- Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të vendosë për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar më lart, ajo mbledhet perseri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 7 Administrimi i Shoqërisë

- 7.1 Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori.
- 7.2 Administratori emërohet me vendim të Ortakeve dhe qëndron në këtë detyrë për një afat jo më të gjatë se 5 vjet. Administratori mund të rizgjidhet për të njëjten periudhë me vendim të Ortakeve të shoqërisë. Administratori është personalisht përgjegjës përpara Shoqërisë dhe/ose paleve të treta për dëmet të shkaktuara nga shkelja e dispozitave të këtij Statuti ose të Ligjit.
- 7.3 Administrator i parë i Shoqërisë për një periudhë 5(pesë) vjeçare do të jetë; **z. Albert Valteri**, i biri i Hajredin-it, i dtl.16.08.1981, lindur në Vinjoll, Mat, banues në njësinë administrative Kashar, Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit me nr.personal I10816168D.

## Neni 8 Detyrat dhe Kompetencat e Administratorit

- 8.1 Pasuria dhe aktiviteti tregtar i Shoqërisë do të administrohen nga Administratori, i cili ka të drejtë të ushtroje të gjitha kompetencat që gjykon të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë,





me perjashtim te atyre qe ky statut dhe ligji i ka rezervuar Ortakeve te Shoqerise. Administratori mund te autorizoj apo emeroje me ane te prokures persona te trete per kryerjen e veprimtarive dhe/ose kompetencave qe i perkasin Administratoreve.

- 8.2 Kompetencat e Administratorit ne lidhje me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise percaktohen por pa u kufizuar, si me poshte vijon.
- a) Te zbatoje politikat tregtare te Shoqerise dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
  - b) Te siguroje qe Shoqeria respekton ligjin(et) e zbatueshem dhe standardet kontabel;
  - c) Te kryeje te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise;
  - d) Te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta, entiteve publike apo private, si dhe entiteve/ose autoriteteve vendase ose te huaja;
  - e) Te pergatite dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise te cilat do te miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.
  - f) Te kryeje te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine sipas parashikimeve te ligjit te ne fuqi;
  - g) T'i raportoje Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare qe mund te konsiderohen me rendesi te vecante per Shoqerine;
  - h) Te punesoje dhe te shkarkoje punonjes sipas politikave te shoqerise;
  - i) Te hartoje dhe te nenshkruaje deklaratat tatimore dhe cdo akt tjeter qe ka lidhje me dokumentacionin qe duhet te dorezohet prane QKB-se ose autoriteteve te tjera.
  - j) Te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne Statut.

### **Neni 9 Audituesi(t) Ligjor**

Audituesi(t) ligjor do te emerohet(n) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rastet kur kjo eshte kerkese e legjislacionit shqiptar. Riemerimi i Audituesit(ve) ligjor do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Audituesi(t) ligjor mund te shkarkohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rast te shkeljeve te detyrave, gabimeve dhe sjelljes jo te mire profesionale.

### **Neni 10 Viti Ushtrimor**

Viti Ushtrimor fillon ne 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe perfundon me date 31 dhjetor 2021.

### **Neni 11 Shperndarja dhe Prishja**

- 11.1 Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve. Shperndarja e shoqerise do te ndiqet nga prishja e saj.
- 11.2 Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik, i cili do te sherbeje per qellimet e likuidimit dhe emrin e shoqerise do ta pasojne fjalet "ne proces likuidimi"



11.3 Likuidatori(et) do te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve. Prishja e Shoqerise dhe emerimi i likuidatorit(ve) do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 12**  
**Ligji i Zbatueshem**

12.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptar.  
12.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar per shoqerite tregtare.

**Neni 13**  
**Mosmarreveshjet**

Per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ndermjet Shoqerise dhe paleve te treta, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jene gjykatat shqiptare.

**Neni 14**  
**Ndryshimet**

Ky statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Ky statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar i shoqerise Everest Automotive shpk hartohet ne 3(tre) kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte secila.

**Ortaku i vetem i shoqerise**  
**Per shoqerine Everest shpk**  
**Sipas vendimit te asamblese**

z. Albert Velfari

